



QENDRA PËR
MENAXHIM ME
NDRYSHIME



MONITORIMI
DREJTËSISË
ADMINISTRATIVE

SI TË ARRIHET DERI TE DREJTËSIA ADMINISTRATIVE?

PYETJE DHE PËRGJIGJE
RRETH PROCEDURAVE-KËRKESAVE
TË NDRYSHMEADMINISTRATIVE
ANKESAT DHE PADITË NGA QYTETARËT
LIDHUR ME ADMINISTRATËN



**SI TË ARRIHET DERI TE
DREJTËSIA ADMINISTRATIVE?**

**PYETJE DHE PËRGJIGJE
RRETH PROCEDURAVE-KËRKESAVE
TË NDRYSHME ADMINISTRATIVE
ANKESAT DHE PADITË NGA QYTETARËT
LIDHUR ME ADMINISTRATËN**



SI TË ARRIHET DERI TE DREJTËSIA ADMINISTRATIVE?

PYETJE DHE PËRGJIGJE RRETH PROCEDURAVE-KËRKESAVE TË NDRYSHME ADMINISTRATIVE ANKESAT DHE PADITË NGA QYTETARËT LIDHUR ME ADMINISTRATËN

Botues: Qendra për menaxhim me ndryshime

Për botuesin: Neda Maleska Saçmaroska, Qendra për menaxhim me ndryshime

Autorë: Tereza Lazovska

Redaktorë: Gordana Stefkovska – Veljanovska

Përkthimi dhe lektura: AD Verbum

Dizajn dhe shtyp: Brigada dizajn

Tirazhi: 200 kopje (Falas/Tirazh jokomercial)

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

35.077.2/.3(497.7)(036)

LAZOVSKA, Tereza Si të arrihet deri të drejtësia administrative? : pyetje dhe përgjigje rreth procedurave-kërkesave të ndryshme administrative: ankesat dhe paditë nga qytetarët lidhur me administratën / [Tereza Lazovska]. - Shkup : Qendra për menaxhim me ndryshime, 2017. - 30 str. : ilustr. ; 24 cm Publikacijata e во рамките на проектот: "Monitorimi drejtësisë administrative"

ISBN 978-608-4818-11-3

а) Јавна администрација - Управни постапки - Македонија - Водичи б)

Јавна администрација - Тужби - Македонија - Водичи в) Административни постапки

COBISS.MK-ID 103017482



British Embassy
Skopje

Projekti është i mbështetur nga Ambasada Britanike Shkup

Ambasada Britanike Shkup mbështeti përgatitjen e këtij materijali, brenda projektit "Monitorim i Drejtësisë Administrative".

Përmbajtja e këtij materijali nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin apo mendimet e Ambasadës Britanike.

ÇFARË ËSHTË NJË PROCEDURË ADMINISTRATIVE?

Gjatë gjithë jetës së vet, çdo qytetar shumë herë është palë në procedurë në të cilën si njëra palë paraqitet shteti, komuna ose personi fizik ose juridik që ushtron autorizime publike (administratë apo organ publik). Kjo procedurë quhet procedurë administrative.

Rregullat e procedurës administrative zbatohen gjithmonë kur administrata vendos mbi një kërkesë specifike për realizimin e një të drejte ligjore nga qytetarët. Kjo zbatohet dhe atëherë kur vetë administrata, pa e kërkuar qytetari, miraton vendim me të cilin imponon detyrime të caktuara për qytetarët.

Ç'ËSHTË DREJTËSIA ADMINISTRATIVE?

Mundësia e qytetarëve në mënyrë të shpejtë dhe efektive ti realizojnë ose mbrojnë të drejtat e tyre para administratës, quhet drejtësi administrative. Me fjalë të tjera, drejtësia administrative është një sistem rregullash që garantojnë miratim të vendimeve të ligjshme nga ana e administratës brenda një afati të arsyeshëm.

Pikërisht rregullat e procedurës administrative në bazë të së cilës është e obliguar të veprojë administrata, vendosen që të sigurojnë siguri juridike në procesin e vendimarrjes, por edhe për të siguruar një shkallë të mjaftueshme të mbrojtjes ligjore të qytetarëve kundër vendimeve me të cilat vendoset për të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Përveç kësaj, mbrojtja juridike e qytetarëve përforcohet dhe me ekzistencën e mekanizmave të tjerë të jashtëm të kontrollit, të vendimeve të administratës, të tilla si kontrolli administrativ dhe gjyqësor ose mbrojtjen e dhënë nga Avokati i Popullit.


Megjithatë, pa marrë parasysh sa i përsosur është sistemi i rregullave përmes së cilëve duhet të sigurohet drejtësi administrative (që nuk është) megjithatë është i nevojshëm zhvillimi i vazhdueshëm i vetëdijes së qytetarëve, me qëllim të njoftimit me të drejtat që i kanë.

Vetëm qytetarët e vetëdijshëm dhe të informuar nuk do të qëndrojnë të heshtur kur të drejtat e tyre shkelen.

SI TË ARRIHET DERI TE DREJTËSIA ADMINISTRATIVE?

ÇFARË LLOJ PROCEDURASH ADMINISTRATIVE EKZISTOJNË?

Këto përfshijnë një numër të madh të procedurave, nga më të thjeshtat, të tilla si procedura për lëshimin e dokumenteve personale (letërnjoftim, pasaportë, etj), deri në procedura më komplekse, të tilla si, për shembull, procedura të shpronësimit, procedura për dhënien e lejes së ndërtimit apo kohët e fundit, procedura e tanishme për privatizimin e tokës ndërtimore dhe kështu me radhë. Me fjalë të tjera, vendimet që merren në procedurën administrative kanë të bëjnë me të gjitha segmentet e jetës së përditshme të qytetarëve, siç janë arsimit, kujdesi shëndetësor, mbrojtja sociale, sigurimi pensional dhe invalidor, tatimet, lëshimi i licencave të ndryshme dhe lejeve, dokumenteve personale dhe kështu me radhë.



Duke pasur parasysh se çfarë vendos administrata për një numër të çështjeve që prekin jetën tonë të përditshme, është e rëndësishme që administrata të jetë cilësore, efikase dhe e përgjegjshme. Gjithashtu, është e rëndësishme që qytetarët të kenë mundësi ti kontestojnë vendimet e miratuara konkrete para një organi më të lartë, me qëllim të mbrojtjes nga veprimet e paligjshme të administratës.

ÇFARË INFORMACIONI OFRON KJO BROSHURË?

Në këtë broshurë ofrohen informata të përgjithshme për qytetarët, dhe ata kanë të bëjnë me rrjedhën e procedurave administrative, me theks të veçantë në të drejtën e ankesës dhe të drejtën e padisë.

Në tekst do të jepen informacione bazë në lidhje me koston e procedurës administrative, si shumë të rëndësishme për të arritur një nga parimet themelore të drejtësisë administrative, dhe kjo është - qasjen në drejtësi. Në fund, do të jepen informacione të përgjithshme për Inspektoratin Administrativ Shtetëror dhe Avokatin e Popullit, si mekanizma të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve në marrëdhëniet me administratën.

1. RRJEDHA E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE



SI TË ARRIHET DERI TE DREJTËSIA ADMINISTRATIVE?


ÇFARË ËSHTË PROCEDURA ADMINISTRATIVE?

Procedura administrative paraqet rregulla të caktuara procedurale në bazë të të cilëve administrata është e obliguar të veprojë. Këto rregulla i obligojnë organet publike të veprojnë në një mënyrë të caktuar, por edhe brenda afateve saktë të përcaktuara.



ÇFARË LLOJE TË PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE EKZISTOJNË?

Ka dy lloje të procedurave administrative:



Procedura e përgjithshme administrative: e obligueshme për të gjithë administratën.

Procedurë e veçantë administrative: vlen vetëm për një lëmi të caktuar, zbatohet vetëm nga një organ të veçantë publik, dhe me të mund të parashihen rregulla të tjera, të ndryshme nga procedurat e procedurës së përgjithshme administrative.



Shembull:

Procedurat tatimore, procedurat doganore, procedura e inspektimit etj.

SI INICIOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE?

Procedura administrative mund të iniciohet:



- me **kërkesë të qytetarit** (procedura mund të iniciohet edhe me kërkesë të një personi juridik ose me kërkesë të palëve të tjera, por në këtë tekst me termin palë nënkuptohet qytetari).
- me **detyrë zyrtare** nga vetë organi publik kompetent.

Shembull:


vendimi i parë që përcakton shumën e tatimit të pronës, për një tatimpagues, komuna e miraton bazuar në Formularin e paraqitjes së tatimeve nga tatimpaguesi, dhe të gjitha vendimet e mëvonshme miratohen në mënyrë zyrtare.

KËRKESË

Gjithmonë kur bëhet fjalë për realizimin e një të drejte të caktuar të qytetarit në procedurë administrative, procedura iniciohet me kërkesën e tij.

Nga momenti i dorëzimit të kërkesës, fillojnë të rrjedhin të gjitha afatet në procedurë.

Kërkesa zakonisht dorëzohet në një formular të caktuar dhe pranimi i kërkesës duhet gjithmonë të konfirmohet me vulë pranuese të organit publik ku dorëzohet, me përjashtim të rasteve kur kërkesa dorëzohet në mënyrë elektronike.



DOKUMENTACIONI (DËSHMI)

Zakonisht, me kërkesën qytetari bashkëngjit dokumente të caktuara për të dëshmuar se i plotëson kushtet për të drejtën, realizimin e së cilës e kërkon.

CILAT DOKUMENTE OBLIGOHEM TI DORËZOJ?

Qytetari në procedurë administrative është i obliguar ti dorëzojë vetëm ato dokumente/dëshmi të natyrës personale, apo dëshmi personale që shteti nuk i posedon në evidencën e vet.

Shembull:

certifikatë mjekësore, diplomat, elaborate të ndërtimit, kontratat e shitblerjes, kontrata për qira dhe ngjashëm.

CILAT DOKUMENTE NUK JAM I OBLIGUAR TI DORËZOJ?

Qytetari nuk është i obliguar të paraqesë dëshmi për të dhëna që organet publike mbajnë evidencë zyrtare, të tilla si certifikatë të shtetësisë apo certifikata të ndryshme, certifikata të lindjes, licenca, leje etj.

E rëndësishme:

Për dallim nga procedurat e tjera, në procedurën për ndihmë sociale qytetari nuk ka asnjë shpenzim në sigurimin e dokumenteve.

SI TË ARRIHET DERI TE DREJTËSIA ADMINISTRATIVE?


Shembull:

në procedurën për realizimin e së drejtës për ndihmë sociale, qytetari me vete duhet të ketë vetëm letërnjoftim dhe të dorëzojë kërkesë në Qendrën për Punë Sociale në vendin ku jeton. Të gjitha dokumentet e nevojshme për procedurën Qendra do ti sigurojë vet në mënyrë zyrtare (dëshmi nga Drejtoria e të Ardhurave Publike), Drejtoria e menaxhimit me librat amë, Agjencia e Kadastrës së pasurive të paluajtshme, Agjencia për punësim, Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor ose nga Ministria e Brendshme).

ÇFARË ËSHTË I ASHTU QUAJTURI SISTEM NJË-SPORTEL?

Dëshmitë për të cilat organet publike mbajnë evidencë zyrtare qytetari mundet ti dorëzojë, por nuk e ka patjetër. Nëse qytetari kërkon, këto dëshmi organi duhet ti sigurojë vet me detyrë zyrtare.

Të gjitha shpenzimet për sigurimin e këtyre dëshmive përsëri do ti paguajë vetë qytetari, por në vend që të shkojë nga sporteli në sportel, atë do ta bëjë organi ku e dorëzon kërkesën. Ky quhet sistem një-sportel.



SI MUND TA DI SE CILAT DOKUMENTE JAM I OBLIGUAR T'I DORËZOJ?

Zakonisht, në vetë formularin për parashtrimin e kërkesës për realizimin e së drejtës është përcaktuar se cilat dokumente janë të nevojshme ti parashtrorj, dhe cilat dokumente sigurohen me detyrë zyrtare.



KUSH MË GARANTON SE DOKUMENTET E MIA NUK DO TË HUMBEN?


Në qoftë se përveç kërkesës dorëzoni ndonjë dokumentacion, është e rëndësishme të siguroni dëshmi për atë se cilat dokumente i bashkëngjitni. Kjo është veçanërisht e rëndësishme që të mbroheni nga humbja e dokumentacionit, diçka që nuk është dukuri e rrallë në administratë.

Ndonjëherë dokumentacioni jo i plotë mund të jetë një arsye bazë për refuzimin e kërkesës, ndërsa posedimi i dëshmisë se dokumenti ka qenë i bashkëngjitur me kërkesën mund të jetë çështja kryesore për të mbrojtur të drejtën tuaj në procedurë ankesore ose gjyqësore.



Shembull:

në konkurset për ndarjen e bursave për nxënësit dhe studentët gjithmonë theksohet se aplikacionet e pakompletuara nuk do të jenë subjekt i shqyrtimit të mëtejshëm, gjë që është shumë e rëndësishme që nxënësi ose studenti të ketë kujdes që dokumentacionin ta ketë të kompletuar, por edhe të ketë dëshmi për dokumentet e bashkëngjitur. Zakonisht kërkesa dorëzohet me formular të përcaktuar ku listohen dokumentet që duhet të dorëzohen në bashkëngjitje, por pak kush kujdeset që formulari të plotësohet si duhet- të rrethohen dokumentet e bashkëngjitura, ajo të konfirmohet me nënshkrimin e personit zyrtar dhe formulari të jetë i vulosur nga Ministria e arsimit dhe shkencës.



VENDIMI MBI KËRKESËN

Për çdo kërkesë të dorëzuar, administrata është e obliguar të vendosë me shkrim, ose është e obliguar me shkrim ta zgjidh çështjen. Vendimi duhet ti dorëzohet qytetarit.

Administrata apo organi publik që vendos mbi kërkesën e qytetarit quhet *organi i shkallës së parë*.

NË ÇFARË AFATI DUHET QË TË VENDOSËT MBI KËRKESËN?

Administrata duhet të vendosë në afat sa më të shkurtër.

Sidoqoftë , *afati maksimal është 30 ditë* nga dita kur një qytetar dorëzon kërkesën me të gjitha dëshmitë e obliguara për ti dorëzuar. Me ligj mund të përcaktohet një afat tjetër, por zakonisht afati është midis 15 deri 30 ditë, në varësi të kompleksitetit të procedurave.

Në procedurat më të ndërlikuara *afati mund të zgjatet edhe për 30 ditë*, por vetëm nëse ajo nuk është e ndaluar me ligj. Sidoqoftë, afati nuk mund të zgjatet, nëse qytetari nuk është i informuar në lidhje me zgjatjen.

SI TË ARRIHET DERI TE DREJTËSIA ADMINISTRATIVE?



KUR FILLON TË RRJEDHË AFATI?

Afati fillon të rrjedhë nga momenti kur *kërkesa është e kompletuar me të gjitha dëshmitë.*

ДАЛИ РОКОВИТЕ СЕ ЗАДОЛЖИТЕЛНИ ЗА АДМИНИСТРАЦИЈАТА?

Afatet për veprim janë të *domosdoshme* dhe nuk varen nga vullneti i administratës.


Për çdo shkelje të kushteve, zyrtari përgjigjet në aspekt kundërvajtës dhe disiplinor dhe prandaj është e rëndësishme që qytetarët të alarmojnë organet kompetente kurdo që ka vonesa.

SI TË MBROHEM NGA HESHTJA E ADMINISTRATËS?

Nëse administrata nuk vendosë brenda afatit, atëherë qytetari ka *të drejtë të ankohet për shkak të heshtjes së administratës.* Ankesa dorëzohet tek organi më i lartë publik i quajtur organi i shkallës së dytë.

Në rastin e justifikimit të ankesës për shkak të heshtjes së administratës, organi i shkallës së dytë mund të urdhërojë organin publik të marrë një vendim brenda një afati të caktuar, ose mund të vendosë vetë mbi kërkesën.

Megjithatë, e drejta e ankesës nuk është e garantuar në të gjitha procedurat, kështu që në rast se nuk është e parashikuar e drejta e ankesës, ndërsa organi publik është i heshtur, atëherë qytetari ka të drejtë të iniciojë *procedurë administrative para Gjykatës Administrative.* Gjithashtu, qytetarët kanë në dispozicion edhe masa të tjera mbrojtëse për të parandaluar zvarritjen e procedurave nga ana e administratës.



Shembull:

pas skadimit të afatit, qytetari mund të dorëzojë parashtrësë te Inspektorati Shtetëror Administrativ i cili është i obliguar të kryejë inspektim të jashtëzakonshëm te organi publik që e zbaton procedurën. Në qoftë se, konstaton se nuk ka shkaqe të arsyeshme për mos marrje vendim mbi kërkesën, inspektorati administrativ do të urdhërojë nëpunësin ta zgjidhë çështjen brenda një afati të caktuar. Një tjetër mekanizëm i rëndësishëm për mbrojtje në raste të tilla, është Avokati i Popullit deri te i cili qytetari mund të dorëzojë parashtrësë.

A MUND TË ANKOHEM PËR VENDIMIN?

Nëse qytetari nuk është i kënaqur me mënyrën e vendimit, ka të drejtë të ankohet, por *vetëm nëse ankesa është e garantuar me ligj*. Kjo do të thotë se e drejta e ankesës duhet të rregullohet me ligj në fuqi që ka të bëjë me çështjen konkrete.

Shembull:

nëse bëhet fjalë për procedurën e realizimit të së drejtës së pensionit sipas moshës, asaj familjare ose invalidore, zbatohet Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor, dhe nëse qytetari ka të drejtën e ankesës varet se si kjo çështje është e rregulluar me këtë ligj (në këtë Ligj është paraparë e drejta e ankesës).



A MUNDEM DHE KUR MUND TË SHKOJ DIREKT NË GJYKATË?

Në qoftë se e drejta e ankesës është e garantuar me ligj, atëherë qytetari *duhet ta përdor të drejtën e ankesës* para se të ngre kontest administrativ në Gjykatën Administrative, apo nuk do të mundet të iniciojë direkt kontest administrativ, nëse më parë nuk e ka përdorur të drejtën e ankesës.

Në qoftë se e drejta e ankesës nuk është e rregulluar për procedurën konkrete, atëherë qytetari dorëzon direkt ankesë për fillimin e kontestit administrativ në Gjykatën Administrative.

KU DORËZOHET ANKESA?

Ankesa dorëzohet direkt në *organin e shkallës së dytë kompetent* për të vendosur nëse ankesa është e bazuar apo e pabazë.

Ajo se cili organ i shkallës së dytë është kompetent për të vendosur në procedurën konkrete, gjithashtu rregullohet me ligjin që ka të bëjë me çështjen konkrete.

Në sistemin tonë juridik ka një larmi të madhe në lidhje me organet që janë kompetente për të vendosur mbi ankesat.

Shembull:

- Komisioni Shtetëror për vendimmarrje në procedurat administrative dhe procedurat e punësimit në shkallë të dytë,
- Komisioni Shtetëror për vendimmarrje në shkallë të dytë në fushën e mbikëqyrjes së inspektimit dhe procedurës kundërvajtëse,
- Komisioni shtetëror për ankesa në prokurime publike,
- Ministri përkatës i dikasterit, disa nga organet që mbikëqyrin punën e personave juridik që ju japin qytetarëve shërbime me interes publik (p.sh. Agjencia për komunikime elektronike për punën e operatorëve të telekomunikacionit) e të tjerë.

SI TË ARRIHET DERI TE DREJTËSIA ADMINISTRATIVE?

Sidoqoftë, pavarësisht diversitetit të tillë të organeve të shkallës së dytë, qytetari nuk do të ketë nevojë për ekspertizë ligjore për të kuptuar se ku duhet ta dorëzojë ankesën, duke pasur parasysh se për atë duhet të udhëzohet nga vetë vendimi me të cilin është vendosur mbi kërkesën e tij. Nëse është udhëzuar gabimisht, që mund të jetë rast, qytetari nuk do të vuajë pasoja dhe më mirë është të veprojë në përputhje me atë që thuhet në këshillën juridike, veç nëse nuk është i sigurt se duhet të veprojë ndryshe.

BRENDA CILIT AFAT DORËZOHET ANKESA?

Ankesa duhet të dorëzohet *brenda 15 ditëve* nga dita kur deri te qytetari është dorëzuar vendimi mbi kërkesën, përveç nëse me ligj nuk është paraparë afat më i shkurtër apo më i gjatë. Për shembull, afati për ankesë në procedurat e inspektimit është 8 ditë, dhe afati prej 8 ditëve është dhënë edhe në procedurat e prokurimit publik.



ÇFARË NDODH NËSE E VONOH AFATIN E ANKESËS?

Në rastin kur një kërkesë është dorëzuar pas afatit, organi i shkallës së dytë do të refuzojë ankesën dhe nuk do të angazhohet në shqyrtimin e saj.

SI LLOGARITEN AFATET?

Si ditë e parë e afatit konsiderohet dita e parë pasi qytetari ta pranojë vendimin, pra dita e pranimit nuk është konsideruar brenda afatit, dhe dita e fundit konsiderohet dita kur skadon afati. Nëse dita e fundit e afatit bie në ditë jopune apo në festë shtetërore, afati skadon ditën tjetër të punës. Nëse ankesa është dorëzuar me postë, nevojitet të jetë me postë të rekomanduar, me qëllim të respektimit të afatit.

BRENDA CILIT AFAT ORGANI I SHKALLËS SË DYTË DUHET TË VENDOS PËR ANKESËN?

Organi i shkallës së dytë ka afat 60 ditë të miratojë vendim në lidhje me ankesën e parashtruar.

Për procedura të caktuara mund të parashihet edhe *afat më i shkurtër*.

KUR FILLON TË RRJEDHË AFATI?

Afati fillon nga dita kur organi i shkallës së parë i ka dorëzuar të gjitha shkresat e lëndës te organi i shkallës së dytë.

Kjo do të thotë se afati nuk fillon të rrjedhë nga momenti kur është dorëzuar ankesa, por nga momenti kur të gjitha dokumentet janë kompletuar për këtë rast.

SI TË MBROHEM NGA HESHTJA ORGANIT TË SHKALLËS SË DYTË?

Edhe në këtë rast, në qoftë se organi i shkallës së dytë nuk merr vendim brenda afatit ligjor, qytetari mund të ngritë parashtrësë te Inspektorati Administrativ Shtetëror apo te Avokati i Popullit.

Nëse përcaktohet se organi i shkallës së dytë e vonon padrejtësisht vendimin për ankesën, inspektori administrativ do të urdhërojë nëpunësin ta zgjidh çështjen brenda një afati të caktuar, dhe këtë do ta kërkojë edhe Avokati i Popullit.

ÇFARË VENDIMESH SJELL ORGANI I SHKALLËS SË DYTË?

Organi i shkallës së dytë mund ta refuzojë ankesën si të pabazuar, ose ta pranojë atë. Nëse e pranon ankesën, organi i shkallës së dytë mund ta zgjidhë vetë çështjen, por zakonisht ndodh që zgjidhjen e çështjes përsëri ta kthejë te organi i shkallës së parë.

KUSH E DORËZON VENDIMIN E SHKALLËS SË DYTË DERI TE QYTETARI DHE BRENDA CILIT AFAT?

Organi i shkallës së dytë e dërgon vendimin e vet te organi i shkallës së parë, që është i obliguar vendimin ta dorëzojë te qytetari brenda 8 ditëve nga dita e pranimit.

PËRSËRITJA E PROCEDURËS DHE VENDIMIT TË ORGANIT TË SHKALLËS SË PARË

Nëse organi i shkallës së dytë e kthen çështjen sërish në procedurë, atëherë organi i shkallës së parë është i obliguar të marrë një vendim të ri në përputhje me vërejtjet e organit të shkallës së dytë, brenda afatit 30 ditësh.

SI TË ARRIHET DERI TE DREJTËSIA ADMINISTRATIVE?

PO ÇFARË NË QOFTË SE DORËZOJ ANKESË KUNDËR NJË AKTI QË NJË HERË KA QENË I ANULUAR?

Kundër vendimit të ri të miratuar qytetari ka të drejtë sërish të ankohe.

Por, gjatë ankesës së sërishme, organi i shkallës së dytë nuk mundet më në asnjë rast lëndën sërish ta kthejë në organin e shkallës së parë, por obligohet që vetë ta zgjidhë çështjen.

Ky rregull zbatohet për procedurat e filluara pas 1 gushtit të vitit 2016 dhe zbatimi i tij duhet të kontribuojë në shkurtime të kohëzgjatjes së procedurave.

KU MUND TË NGRE PADI?

Padia për ngritjen e kontestit administrativ, dorëzohet në *Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë*.

KUR MUND TË PADISË?

Padi mund të ngritet në rastet e mëposhtme:

- kundër vendimit të shkallës së dytë
- për shkak të heshtjes së organit të shkallës së dytë (nëse nuk e zgjidhë çështjen brenda 60 ditëve ose në një afat më të shkurtër të caktuar me ligj)
- kundër vendimit të shkallës së parë (në qoftë se nuk është paraparë një e drejtë e ankimit)
- për shkak të heshtjes së organit të shkallës së parë (në qoftë se nuk është paraparë e drejta e ankesës, ndërsa organi i shkallës së parë nuk e zgjidh çështjen brenda 30 ditëve, ose në ndonjë afat tjetër të përcaktuar me ligj).



BRENDË CILIT AFAT NGRITET PADI?

Padia ngritet brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të vendimit të qytetari.

ÇFARË DUHET TË BËJ PARA SE TË NGRE PADI PËR SHKAK TË HESHTJES SË ADMINISTRATËS?

Në rast të heshtjes së organit të shkallës së parë ose të shkallës së dytë, është e rëndësishme të dini para se të ngrini padi në Gjykatën Administrative, qytetarët duhet të drejtohet sërish në organin e shkallës së parë, apo të shkallës së dytë, duke kërkuar që rasti të zgjidhet.

Nëse organi nuk miraton asnjë vendim brenda 7 ditëve nga kërkesa e përsëritur, vetëm atëherë mund të ngritet padi kundër heshtjes (sikur të jetë refuzuar kërkesa apo ankesa).

Nëse një qytetar nuk e respekton këtë procedurë, Gjykata do të marrë një vendim të hedhjes poshtë të padisë si të parakohshme.

ÇFARË VENDIME MIRATON GJYKATA?

Duke vepruar lidhur me padinë Gjykata Administrative mund ta refuzojë padinë si të pabazë ose ta pranojë.

Nëse Gjykata e pranon padinë, mund **ta anulojë aktin administrativ** dhe në këtë rast lënda kthehet në gjendjen që ka qenë para miratimit të aktit të anulimit.

Shembull:

nëse Gjykata anulon vetëm aktin e organit të shkallës së dytë (që në procedurat ku është paraparë ankesa ndodh zakonisht), atëherë rasti kthehet në fazën e ankesës, apo lënda kthehet përsëri para organit të shkallës së dytë që është i obliguar përsëri të vendosë lidhur me ankesën, duke marrë parasysh qëndrimet e Gjykatës Administrative të theksuara në aktgjykim. Vendimin e ri organi i shkallës së dytë duhet ta miratojë në afat prej 30 ditëve nga pranimi i vendimit në fuqi të Gjykatës.

Përveç që mund ta anulojë aktin e kontestuar, Gjykata mund të vendosë vetë mbi çështjen administrative me çfarë procedura do të përfundonte pa u kthyer për vendim në organin e shkallës së dytë ose të parë.

A ËSHTË E OBLIGUAR ADMINISTRATA TI RESPEKTOJË VENDIMET E GJYKATËS?

Po. Megjithatë, ajo që është e rëndësishme të dinë qytetarët për kontestet administrative dhe mënyrën e vendimmarrjes së Gjykatës Administrative është se një padi e pranuar nuk do të thotë automatikisht se edhe Gjykata ka konstatuar se qytetari i përket një e drejtë e caktuar.



SI TË ARRIHET DERI TE DREJTËSIA ADMINISTRATIVE?

Shembull:

Gjykata mund ta pranojë padinë dhe të anulojë aktin e kontestuar administrativ, sepse ka gjetur se organi i paditur në vendimin e vet nuk ka shpjeguar arsyet për refuzimin e kërkesës së qytetarit, por kjo nuk do të thotë se Gjykata ka konstatuar se qytetarit duhet ti njihet e drejta të cilën e ka kërkuar.

Prandaj, në praktikë, shpesh ndodh që organet e paditura sërish të marrin vendime me të cilat refuzohen kërkesat e qytetarëve (në të cilat korrigjohen mangësitë e theksuara nga Gjykata) dhe kjo interpretohet si mos respektim i vendimeve të Gjykatës, që nuk do të thotë të jetë gjithmonë rast.


A ËSHTË PARAPARË E DREJTA E ANKESËS KUNDËR VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE?

Kundër vendimeve të Gjykatës Administrative mund të bëhet ankesë në Gjykatën e Lartë Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit te qytetari.

PARAQITJE SKEMATIKE E RRJEDHËS SË PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE



2. SHPENZIMET NË PROCEDURËN ADMINISTRATIVE



SI TË ARRIHET DERI TE DREJTËSIA ADMINISTRATIVE?

SA KUSHTOJNË PROCEDURAT ADMINISTRATIVE?

Pjesëmarrja e qytetarëve në procedurat administrative dhe kontestet është më e lirë se pjesëmarrja në procedurat e rregullta gjyqësore.

Me përjashtim të procedurave më komplekse, në këto procedura rrallë ka nevojë për ndihmë juridike nga një avokat. Për shkak se shpenzimet janë ulur shpesh me koston e tarifave administrative dhe gjyqësore dhe koston e sigurimit të dëshmimeve në procedurë (p.sh. dokumente të ndryshme publike, elaborate, etj).

Dokumentet dhe veprimet në procedurë që organet administrative i bëjnë me detyrë zyrtare nuk janë subjekt i pagesës së taksave (p.sh. vendim që konstaton detyrimin për të paguar tatimin).



A KA MUNDËSI TË LIRIMIT NGA SHPENZIMET E PROCEDURËS?

Ashtu si në procedurat gjyqësore ashtu edhe në ato administrative *ka mundësi të lirimit nga shpenzimet procedurale*, nëse shpenzimet e theksuara do të ndikonin në mirëmbajtjen e tyre apo të familjeve të tyre.

Lirimi bëhet me kërkesë të qytetarit, për çfarë vendos vetë organi administrativ ose gjykata në të cilën mbahet procedura, bazuar në sigurimin e vërtetimit të fletëpronësisë së qytetarit, që sigurohet me detyrë zyrtare dhe për të cilën nuk paguhet taksë administrative.

Në procedurë administrative, përveç lirimeve individuale, në fusha të caktuara ekziston edhe lirim i përgjithshëm nga taksat administrative për të gjithë qytetarët.

Shembull:



lirim për të gjitha dokumentet dhe veprimeve për realizimin e të drejtës për sigurim pensional apo dokumentet dhe veprimet në procedurën e arritjes së ndihmës sociale.

Në kontest administrativ, të liruar nga pagesa e taksave gjyqësore janë qytetarët në kontestet administrative në fushën e sigurimeve sociale, ndihmës sociale, kujdestarisë, adoptimit si dhe nga fusha e denacionalizimit.

SA KUSHTOJNË TAKSAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE?

Taksat administrative dhe taksat që paguhen në kontestet administrative janë të rregulluara me Ligjin mbi Taksat Administrative (ku janë paraparë 157 numra të ndryshëm tarifor) dhe me Ligjin për taksat gjyqësore.

Më poshtë janë dhënë disa shembuj të taksave administrative si dhe taksave gjyqësore në kontest administrativ:



3. MEKANIZMA TJERA PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE



SI TË ARRIHET DERI TE DREJTËSIA ADMINISTRATIVE?

Përveç të drejtën e ankesës dhe të drejtën e padisë, qytetarët kanë në dispozicion edhe mekanizma të tjerë për të mbrojtur të drejtat e tyre në procedurë administrative. Mekanizma të tilla janë, për shembull, mundësia e ngritjes së parashtresave në Inspektoratin Administrativ Shtetëror, dhe mundësia e ngritjes së parashtresave te Avokati i popullit. Për parashtresat nuk paguhet taksë.



INSPEKTORATI SHTETËROR ADMINISTRATIV

Çdo qytetar ka të drejtë të paraqesë parashtresa te Inspektorati Shtetëror Administrativ në lidhje me punën e administratës, apo mënyrën si veprohet në një lëndë të veçantë.

Nëse konsideron se është kompetent për të vepruar lidhur me parashtresën, Inspektorati Shtetëror Administrativ kryen inspektim të detyrueshëm të jashtëzakonshëm te organi publik për të cilin bëhet parashtresa, që mund të ndihmojë në masë të madhe në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve.

PËR ÇFARË JANË KOMPETENT INSPEKTORËT ADMINISTRATIV?

Inspektorët administrativ *nuk kanë kompetencë të ndërhyjnë në ligjshmërinë* e vendimit të miratuar, sepse ajo është puna e organit të shkallës së dytë ose të Gjykatës Administrative. Kjo do të thotë se inspektori administrativ nuk mund të urdhërojë administratën të miratojë një vendim pozitiv ose të urdhërojë anulimin e vendimit të miratuar.

Megjithatë, inspektorati administrativ mundet:

- të urdhërojë administratën të respektojë afatet ligjore për zgjidhjen e lëndëve
- të urdhërojë dorëzimin e vendimit të miratuar te qytetari
- të ndalojë nga qytetari të kërkohet ndonjë vërtetim të cilin organet nuk janë të obliguara ta lëshojnë, ose është e panevojshme në procedurë etj.

Shembull:

Në procedurë për realizimin e të drejtës së kthimit të mjeteve financiare të dhëna për mjekim, inspektori administrativ nuk ka kompetencë të shqyrtojë nëse qytetarit i takon e drejta apo nëse shuma e dhënë është e saktë. Megjithatë, inspektori administrativ mund të ndihmojë në masë të madhe për të përshpejtuar procedurën, dhe ta urdhërojë Fondin e Sigurimeve Shëndetësore të miratojë një vendim në rast se është shkelur afati për vendimmarrje prej 30 ditëve. Nëse inspektori konstaton se nuk ka arsye të vlefshme për shkeljen e afatit, por thjesht lënda është “mbajtur në sirtar”, atëherë ai ngre nismë për konstatimin e përgjegjësisë disiplinore të nëpunësit zyrtar i cili ka udhëhequr me lëndën.



SI TË NGRE PARASHTRESË TE INSPEKTORATI SHTETËROR ADMINISTRATIV?

Parashtresa mund të dorëzohet me shkrim ose me gojë, personalisht ose në numrin falas të Inspektoratit Shtetëror Administrativ: **0800 111 99**.

AVOKATI I POPULLIT

Në rast të shkeljes së të drejtave të qytetarëve nga administrata, qytetarët mund të kërkojnë mbrojtje nga Avokati i Popullit të Republikës së Maqedonisë.

Procedura te Avokati i Popullit inicohet me parashtresë që mund të parashtrohet me shkrim (me postë, faks, e-mail, personalisht në arkivin e Avokatit të Popullit) ose gojarisht.

CILAT JANË KOMPETENCAT E AVOKATIT TË POPULLIT?

Ashtu si Inspektorati Shtetëror Administrativ, Avokati i Popullit nuk ka mandat për të ndryshuar, anuluar ose pezulluar vendimet e administratës.

Megjithatë, ndryshe nga inspektorët administrativ, Avokati i Popullit mund të hetojë ligjshmërinë e vendimeve, dhe në qoftë se gjen shkelje të të drejtës së qytetarit, mund ti japë rekomandime, sugjerime administratës, apo ti theksojë se qytetarit duhet ti njihet ndonjë e drejtë.

SI TË ARRIHET DERI TE DREJTËSIA ADMINISTRATIVE?

SHEMBUJ POZITIV NGA PRAKTIKA E AVOKATIT TË POPULLIT

SHEMBULL 1:

Në zyrën rajonale të Avokati i Popullit në Tetovë parashtresë ka dorëzuar personi nga Gostivari dhe ka kërkuar ndërhyrjen në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor - Dega Gostivar, për të vepruar në përputhje me përmbajtjen e vendimit të Komisionit Shtetëror për vendimmarrje në procedurat administrative dhe procedura të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë, me të cilën është pranuar ankesa e tij.

Avokati i Popullit konstatoi shkelje të së drejtës që përbëhej nga zgjatja e padrejtë e procedurës dhe është drejtuar te Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor - Dega Gostivar, duke kërkuar që menjëherë të fillojë zgjidhjen e lëndës.

Pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit, dorëzuesi i parashtresës e ka realizuar të drejtën e tij (Burimi: Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2015).

SHEMBULL 2:

Një qytetar nga Shkupi ka dorëzuar parashtresë te Avokati i Popullit, ku ka theksuar se pas përfundimit të trajtimit spitalor në Klinikën Universitare të Kardiologjisë në Shkup nuk i është dhënë letër lëshimi për shkak të shpenzimeve të papaguara për shërbimet shëndetësore të ofruara.

Avokati i Popullit me shkrim është drejtuar te institucioni shëndetësor pas së cilës ka konstatuar shkelje të të drejtave të dorëzuesit të parashtresës. Klinika i ka konfirmuar pretendimet e parashtresës.

Për tejkalimin e kësaj situatë, Avokati i Popullit dorëzoi një njoftim me shkrim në Klinikë, me të cilin ka kërkuar që dorëzuesit të parashtresës në afat më të shkurtër ti jepet letra e lëshimit, që ai të mundet të vazhdojë në kohë mjekimin. Gjithashtu, Klinikës i është thënë se një sjellje e tillë është e paligjshme dhe se për arkëtimin e shërbimeve mjekësore ka masa tjera ligjore që Klinika mund ti zbatojë. Rekomandimi i Avokatit të Popullit është pranuar nga Klinika e Kardiologjisë dhe dorëzuesit të parashtresës i është dhënë letra e lëshimit (Burimi: Raporti vjetor i punës së Avokatit të Popullit për vitin 2014).

SHEMBULL 3:

Një qytetar nga Shkupi ka dorëzuar parashtresë te Avokati i Popullit, sepse Fondi për Sigurim Shëndetësor - Zyra Rajonale në Shkup, gati katër vjet nuk ka vepruar sipas aktgjykimit të Gjykatës Administrative, me çka i është mohuar e drejta për rimbursim të mjeteve për shërbimin e kryer shëndetësor.

Avokati i Popullit ka konstatuar se Gjykata Administrative më datë 23.02.2011 ka shqiptuar vendim me të cilin është dashur të veprojë Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, por për shkak se Fondi një periudhë më të gjatë nuk ka vepruar sipas aktgjykimit, dorëzuesi ka dhënë kërkesë me shkrim në Fond dhe në Ministrinë e Shëndetësisë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Avokati i Popullit ka dorëzuar një shkresë në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, që sa më shpejt të jetë e mundur të veprojë në aktgjykimin e Gjykatës Administrative dhe të miratojë vendim për rastin e dorëzuesit të parashtresës

Pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit, Fondi miratoi një vendim përmes së cilit dorëzuesit të parashtresës i janë miratuar dhe rimbursuar fonde për shërbimin e kryer shëndetësor, në përputhje me udhëzimet në aktgjykimin e Gjykatës Administrative, me çfarë dorëzuesi i parashtresës i ka realizuar të drejtat e tij (Burimi: Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2015).

SHEMBULL 4:

Te Avokati i Popullit ka dorëzuar parashtresë një qytetar i Shkupit, i cili ka kërkuar ndërhyrjen në NP Radiotelevizioni i Maqedonisë - Shkup (RTVM), për shkak se, edhe pse është person i shurdhër, me dëgjim të dëmtuar me mbi 60 decibel familja e tij është e detyruar të paguajë taksë radiodifuzive.

Avokati i Popullit ka konstatuar se dorëzuesi i parashtresës i ka plotësuar kushtet e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale që të lirohet nga ky detyrim.

Në këtë aspekt, implikimi i Avokatit të Popullit për lirin nga taksë radiodifuzive është pranuar nga RTVM-ja, dhe qytetari është fshirë nga Regjistri i bonove të taksave radiodifuzive (Burimi: Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2015).

